

KRONIKË E ZEZË

Plagoset një person në një kazino në Breznicë të Bujanocit



Një shtetas i Kosovës është plagosur në oborrin e një kazinoje në fshatin Breznicë të Bujanocit, pranë territorit të Kosovës, njoftoi Policia e Kosovës të martën.

Në njoftim thuhet se për rastin janë arrestuar nëntë persona të dyshuar, brenda territorit të Kosovës.

I plagosuri është dërguar në Spitalin Rajonal të Gjilanit nga një familjar dhe gjendet jashtë rrezikut për jetë.

“Viktima është trajtuar në Emergjencën e Spitalit Rajonal të Gjilanit dhe sipas mjekut kujdestar është jashtë rrezikut për jetë. Njësitit Rajonal i Hetimeve në koordinim të plotë me prokurorin e Shtetit, janë duke i hetuar rrethanat se si ka ndodhur rasti, rast i cili sipas prokurorit është cilësuar ‘Vrasje në tentativë’”, thuhet në njoftimin policor.

Vite më parë, autoritetet kosovare kanë ndërmarrë aksion për ndalimin e ushtrimit të veprimtarisë të paligjshme të lojërave të fatit në Kamenicë. Kazinotë dhe lojërat e fatit janë të ndaluara me ligj nga Qeveria e Kosovës.

15 nëntor 2022, 10:48

Shpërndaje në



© KOHA. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Komento

#FSHATI BREZNICE


#KAMENICË

#KAZINO

#PLAGOSJE

#POLICIA E KOSOVES

TË TJERA



Aktakuzë ndaj 7 të dyshuarve që u kapën me 400 kg kokainë



Deklarohen të pafajshëm të akuzuarit për vrasjen e Bedri Rexhepit



Stanishiqit i ulet dënimi për 5 vjet për vrasjen e civilëve gjatë luftës në Kosovë



Zhduket një grua në Kaçanik